Flash Presidenti i Austrisë, Van der Bellen: Do rrisim marrëdhëniet ekonomike Austri-Shqipëri

SULM ME ARMË DREJT TOP CHANNEL

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Luiz Ejlli shtrihet në krevat dhe qan, ja si reagon Kiara Tito (FOTO)

2 Sulmi në Top Channel/ Kush ishte Pal Kola, 60-vjeçari që punonte roje natën për bukën e gojës! Në tokë u gjet një 5 lekësh që i ra nga xhepi teksa mori plumbin vdekjeprurës



3 Sulmi ndaj Top Channel, Nikoll Lesi: Unë e di mirë se çfarë do të thotë kur të sulmon krimi apo pushteti



4 Sulm me armë drejt Top Channel, reagojnë krerët e shtetit dhe politikës: Agresion kriminal, të zbardhet ngjarja! E dënojnë edhe SHBA, OSBE e BE

5 Carlo Bollino: Politikanët e urrejtjes, bashkëfajtorë moralë në agresionet ndaj medias

Kronikë

VIDEO/ Breshëri kallashnikovi drejt Top Channel, pranë Big Brother, 25 gëzhoja në vendngjarje! Vritet roja, po ngrohej në kabinë! Dyshohet të jenë të paktën 3 autorë

Breshëri kallashnikovi janë regjistruar në mesnatë drejt godinës së Top Channel, afër shtëpisë së Big Brother. Të shtënat me armë i morën jetën rojës, Pal Kola, 60 vjeç, i cili ka qenë duke u ngrohur pranë një ngrohëse që ka pasur brenda kabinës. ***Një makinë e djegur tip 'Range Rover'*** *është gjetur në Golem të Kavajës, e cila dyshohet se u përket autorëve. Brenda saj janë gjetur* ***2 kallashnikovë****.*

- Të shtënat me armë në Top Channel, reagon televizioni: Sulm terrorist
- VIDEO e plotë/ Si reaguan të trembur banorët e Big Brother nga breshëria e kallashnikovit! Kristi: Thashë se ishte këtu brenda
- VIDEO/ Një plumb i mori jetën, video nga kabina ku roja humbi jetën nga të shtënat drejt Top Channel
- VIDEO /Shenjat e plumbave në xhama dhe kangjella, pamjet pas të shtënave drejt Top Channel
- Të shtënat ndaj Top Channel, REAGIMET e politikës
- VIDEO/ 'Ça ishte kjo, kallash?!' Momenti kur Qetsori dhe Kristi tremben nga të shtënat drejt Top Channel

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
27 Mars, 07:05 | **Përditesimi: 27 Mars, 12:30**

TIRANË- Breshëri kallashnikovi janë regjistruar në mesnatë drejt godinës së Top Channel, afër shtëpisë së Big Brother. Të shtënat me armë i morën jetën rojës së godinës, Pal Kola, 60 vjeç. Report Tv ka mësuar se roja i sigurisë ka qenë duke u ngrohur pranë një ngrohëse që ka pasur brenda kabinës në momentet që është qëlluar me breshëri plumbash. 60-vjeçari ka ndërruar jetë rrugës për në spital. Dyshohet se kanë qenë mbi tre persona që kanë marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndë, të paktën 2 kanë qëlluar me breshëri mbi zyrat e Top Channel, ndërkohë që një tjetër ka qenë drejtuesi i makinës.

Një makinë e djegur tip 'Range Rover' është gjetur në nga policia në Golem të Kavajës, e cila dyshohet se u përket autorëve. Gazetari i Report tv, Sokol Dema ka mësuar se në brendësi të mjetit të djegur janë gjetur 2 kallashnikovë. Mjeti 'Range Rover' rezulton e vjedhur në Shkodër . Në vendin e ngjarjes janë gjetur rreth 25 gëzhoja kallashnikovi. Mjaftoi një prej tyre që të linte të vdekur në vend, 60-vjeçarin Pal Kola, i cili mori një plumb në trup. Ende nuk dihet se çfarë motivi mund të fshihet pas këtij sulmi të rëndë ndaj televizionit Top Channel.

LEXO EDHE:
Sulmi ndaj Top Channel, Nikoll Lesi: Unë e di mirë se çfarë do të thotë kur të sulmon krimi apo pushteti

Grupi hetimor është fokusuar në dy pista, një prej tyre mund të jetë një mesazh për pronarët e Top Channel, ndërsa një tjetër pistë është edhe një mesazh kundër produksionit të Big Brother. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për zbardhjen e plotë të saj. Pritet edhe sekuestrimi i kamerave të sigurisë, për të bërë të mundur sado pak zbardhjen e dinamikës së ngjarjes.

lajm ne perditesim....

1 / 13



Makina e djegur e autorëve

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 12:04

Të shtënat me armë në Top Channel, reagon televizioni: Sulm terrorist



Televizioni Top Channel i cili ra pre e një sulmi shumë të rëndë gjatë natës me breshëri kallashnikovi e ka cilësuar si sulm terrorist, pa zbardhur asnjë nga motivet që mund të dyshojnë rreth ngjarjes. Si pasojë e ngjarjes tragjike mbeti i vdekur Pal Kola, 60-vjeçari që punonte si roje sigurie.

NNEL.TV
12:02
SULM TERRORIST NDAJ TOP CHANNEL
BRESHËRIA E PLUMBAVE VRET ROJËN E SIGURISË, PAL KOLA

Ora 11:22

VIDEO e plotë/ Si reaguan të trembur banorët e Big Brother nga breshëria e kallashnikovit! Kristi: Thashë se ishte këtu brenda

Një orë pas mesnatës së mbrëmshme persona ende të paidentifikuar kanë qëlluar me armë drejti ambienteve të Top Channel në Tiranë, pranë shtëpisë ku po zhvillohet spektakli Big Brother VIP. Banorët e shtëpisë së BBV e kanë dëgjuar breshërinë e të shtënave dhe kanë reaguar të trembur, pa ditur se ç'po ndodh! Qetsori, Kristi dhe Nita kanë dëgjuar duke parë njeri-tjetrin me pikëpyetje.

Biseda mes tyre

Kristi pyeti: Çfarë ishte kjo???

Qetsori: Kallash!!!

Kristi: Thashë se ishte këtu brenda!!!

Nita: Ishte afër

Ora 10:07

Një plumb i mori jetën, video nga kabina ku roja humbi jetën nga të shtënat drejt Top Channel

Një plumb i mori jetë rojës Pal Kola, 60 vjeç nga të shtënat drejt Top Channel. Report Tv sjell video nga kabina në të cilin Kola ishte teksa humbi jetën. Në kabinë duket edhe shenja e plumbit që i mori jetën 60-vjeçarit.

Ora 09:10

VIDEO /Shenjat e plumbave në xhama dhe kangjella, pamjet pas të shtënave drejt Top Channel

Report Tv ka siguruar pamjet pranë godinës së Top Channel që u godit me armë dhe për pasojë ndërroi jetë roja i sigurisë Pal Kola, 60 vjeç. Në pamje duken shenjat e plumbave në kangjella dhe xhamat e godinës. Drejt godinës u qëllua me breshëri kallashnikovi dhe në vendngjarje mbetën 25 gëzhoja.

1 / 15

SI.E./r.k./Shqiptarja.com

TAG: big brother | Top Channel | Tirane | big brother vip | pal kola | Sulm me arme Top Channel

Komento

Komente

ARBana: 27/03/2023 12:22

UA PO SI ESHTE E MUNDUR TE GJITH SHQIPTARET E DUAN BIG BROTHERIN. E SHTE EMISIONI ME I NDJEKUR NGA GJITH SHQIPTARET NENPER BOT.... UA UA UA .... TE GJITH JANE DASHURUAR ME TOP CANAL... I KA BER LUISI TA DUAN TOP CANLIN.... ESHTE ME I NDJKURI I TE GJ8THA KOHRAVE.... LUOS LUIS LUIS.... LUISI: UN do ta fitoj big brotherin se jam me sali berishen , mentori im me thote se do ta fitosh edhe me gjak....

Përgjigju

roja: 27/03/2023 12:17

Realitet shqiptar . Roja o vritet o futet ne burg ngaqe pronaret e tyre jane te mpleksur ne dallavere.

Përgjigju

Suela: 27/03/2023 12:15

Gjynaf fukarai,ti marrin jeten per nje kafshat buk.Ky esht krimi,fakarai i gjore,sepse sulmi ndaj Topit esht larje hesapesh mes bandave mafioze,paralajmerim per dike qe ka prish parazaret.Nuk ka si ti kapi drejtesia ne nje vend ku qeveris mafia.

Përgjigju

Alb: 27/03/2023 12:06

Shume ngjarje e ciditshme i ndjeri akoma ska ne foto apo nje familjar te dali te flas topi akoma ska nje reagim.

Përgjigju

Visha: 27/03/2023 11:46

Keto jane gjemat e ilir metes e sali berishes te hapin sa me shume panik ne popull e ne pushtet te iki vemendja nga ata te kete sa me shume destabilizim deri ne zgjedje ata do bejne me shume

Përgjigju

Njoni: 27/03/2023 11:39

Sika mundesi. Qe shumica e makina e qe bohen vrasje Ose atentate vidhen në Shkoder???? Cabo shteti atje fle gjum . dhe pse ikin shqiptaret vijne në angli cate bojn atje osht bo makeq se në ukrahin . Ore se kuptoj Pse nuk vojne monde kosenin drejtor policija në në tiran dhe në gjith shqiperin. Vetem ai e shpeton ate vend. I e boni elbasonin në 1998 perqef sa iku ai filloj loja atje dhe ska mbaruar sot e ksajdite.

Përgjigju

Hajde hajde: 27/03/2023 10:54

Ruaitje e dobet e objektit. Duhet te kishte më shume se nje roje dhe te veshur me jeleke antiplumb. Shume kollaj vrasesit mund te kishin depertuar edhe ne zonen e shtepise se BB, nqs do e kishin si objektiv te vrasjes.

Përgjigju

Dori: 27/03/2023 10:06

Larje hesapesh mes mafias qe posedon mediat dhe gjith politiken ne Shqiperi.Gjith ikin ne drejtim te paditur pondikur qeveria e zinte lepurin me qerre thoshte populli.Ka ik per lesh ky vend pastaj ankohen pse iken rinia.Si te jetosh ne nje shtet mafioz?

Përgjigju

Erik: 27/03/2023 10:01

Besoj se jane gjobvenesit/racket e krahut te majte te autostrades, te njejtet qe kane gjuajtur para 3 vitesh ne te njejten menyre ndaj Kompleksit Eiffel, 1 km larg Top Channel. Ne ate kohe u perfol per grupin e merhumit qe s'gjendet prej gushtit te vitit te kaluar. Qofsha i gabuar.

Përgjigju

Gjergj: 27/03/2023 09:51

Natyrisht qè i duhet lènè organeve tè rendit gjetja e autorève dhe arrestimi i tyre. Kjo, èshtè terminologjia qè pèrdoret pas ngjarjeve tè tilla, ATJE KU SHTETI FUNKSIONON. Çfarè figure jep njè shtet, ku efektivèt e policisè nè uniformè, duhen arrestuar nga grupi i gatshèm SHQIPONJA, sepse nè gjèndje tè dehur, veprojnè si halabakè? Njè ministèr i brendshèm qè jo vetèm nuk e ka haberin nga fusha qè "drejton" por qè nuk njeh asnjè etikè qytetare nè raport me pèrgjegjèsinè. Largohu more zotèri, dorèhiqu. Njè polici e shthurur,vrasje makabèr nè mes tè kryeqytetit (gjèndet makina e vrasèsve e djegur nè Golem). Ik o ik. Dhe nuk kanè turp, shkojnè nè Angli dhe "mbrojnè" shqiptarèt nga politika e atjeshme? Nèse nuk do bèheshe fjalè pèr vendin tim,,do kèputesha sè qeshuri, mirèpo kètu tè rrjedhin lotèt e dèshpèrimit, kur sheh ku ka pèrfunduar gjithçka. Njè shqiptar 60 vjeçar,,humbi jetèn mbrèmè,,,duke qenè nè punè. Si i ndjeri,,mund tè kishte qenè çdonjèri nga ne. Ministri i brendshèm, as qè e sheh tè nevojshme tè prononcohet sepse AQ DI E AQ BÈN. Pèr tè, del kryeministri dhe llomotit. Shqipèri, tè kam dhjerè,,,,,

Përgjigju

Dordomusi: 27/03/2023 09:47

Jane gjujtsat e tik tokut se i kane ren ndjekesit

Përgjigju

adios: 27/03/2023 09:46

der me sot thoja sdo e lem shqiperin tone..por erdhi koha ikjes,duhet braktisur ky vend nje ore e me pare.te shpetojm veten dhe femijet,pa na ardh ndo1 plumb qorr...

Përgjigju

Shkodra: 27/03/2023 09:22

Per cfar jan dronat e policis e satelitet ? Keto kriminela qe vrasin hallexhinj gjuajne pa kriter duhet te kapen sezben me patjeter

Përgjigju

Mjeku: 27/03/2023 09:01

Mediat shqiptare jane lavatrice parash te pista. Keto jane pasojat. Roja ishte nje viktime e pafajshme. Rama ti jap edhe 100 dit afat te tjera policise.

Përgjigju

Eduart: 27/03/2023 08:40

Gjuani arbanen ajone meriton . Te qaje dhe une eduarti

Përgjigju

> **Moshamut:** 27/03/2023 12:22
>
> Po të kishte shtet ti 'eduard' duhej të ndaloheshe për thirrje terroriste!...shokët e tu janë vrasësit e rojes!.

Loni: 27/03/2023 08:28

Kanë dashur të bëjnë terrorr. Idem te Don Bosco. Martinajt?

Përgjigju

Lushka: 27/03/2023 08:28

Seriozisht ka ndodhur!? Uaaaa tmerr! E habitshme kundrejt nje programacioni qe I ka mberthyer MBAs ekranit. Cuditerisht un nuk e ndjej fare fare sepse shum nivle I ulet si programacion... Nesje ketu kan ngelur mbetjet edhe politikanet asgje tjeter... Do jet ndonje fans qe ka terhequr shume...

Përgjigju

Landi: 27/03/2023 08:24

Bravo Arben per komentin, qenke p*ll tamam

Përgjigju

Arben: 27/03/2023 08:08

Te harroje Saliu se me keto gjera mund te trembet kush. Kjo gje me teper i bashkon shqiptaret rreth PS.

Përgjigju

> **Demiri:** 27/03/2023 08:42
>
> Grusht bashkuar rreth Partisë. Ti thyejmë dhëmbët armikut të kllasës punëtore. Armiku Sali e ka fajin, ndaj jemi në këtë gjendje. Në çdo statistikë, të fundit për gjërat pozitive, të parët për ato negative. Armiku Sali ka 10 vjet që e qeveris këtë vend si pashallëk i rrethuar me bashkëpunëtorët e tij hajdutë e pervers. Saliu e ka fajin si antikombëtar e mik me Vuçiç e armik ne Kurtin. Ah Sali Berisha që ke 10 vjet që na pi gjakun!

> **Arbëri:** 27/03/2023 08:38
>
> O lesh kuq, këto krime janë të Edvin shkjaut shqipfolës

> **Maku:** 27/03/2023 08:30
>
> Ca thua o suflaqexhi clidhje ka saliu me kete ngjarje?

> **Benar:** 27/03/2023 08:23
>
> I bashkon rreth ps qe po i dalin te gjithe drejtuesit hajdut. Kete deshe te thoshe beni?

genti: 27/03/2023 07:57

marrezia ska fund ne ate vend ...

Përgjigju

Topqenefi: 27/03/2023 07:17

Kshu esht kur ban pislluqe o top chanel shkak pasoj quhet kjo

Përgjigju

> **Italja si moter:** 27/03/2023 11:17
>
> O te mallkuar ,çfar jane keto komenye dhe pastaj thone qe mungon liria e fjales .po ne vendet e tjera te europes dhe ne amerike pse ndodhin ? d.m.th.edhe atje nuk ka siguri jete ? kush e kruan do ta haje se doni te ikni mbrapa diellit vafshi se me ne fund do te ngelen shqiptaret e ndershem ne Shqiperi .pika pika popull hajdut ju vidhni shtepine tuaj .

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

Kualifikueset e Euro 2024, kush e fiton ndeshjen Poloni-Shqipëri?

Polonia | Shqipëria | Barazim

Lajme të tjera

Carlo Bollino: Politikanët e urrejtjes, bashkëfajtorë moralë në agresionet ndaj medias

Carlo Bollino

27 Mars, 12:10

Sulm me armë drejt Top Channel, eksperti Softa: Akt terrorist! Mjeti i braktisur nuk është djegur plotësisht, jep mundësinë për gjetjen e autorëve

27 Mars, 11:54

Sulmi në Top Channel/ Kush ishte Pal Kola, 60-vjeçari që punonte roje natën për bukën e gojës! Në tokë u gjet një 5 lekësh që i ra nga xhepi teksa mori plumbin vdekjeprurës

27 Mars, 10:47

Sulm me armë drejt Top Channel, reagojnë krerët e shtetit dhe politikës: Agresion kriminal, të zbardhet ngjarja! E dënojnë edhe SHBA, OSBE e BE

27 Mars, 08:49

Vritet roja i sigurisë së Top Channel, presidenti Begaj: Organet ligjzbatuese ta zbardhin sa më shpejt

27 Mars, 08:21



VIDEO/ 'Ça ishte kjo, kallash?!' Momenti kur Qetsori dhe Kristi tremben nga të shtënat drejt Top Channel

27 Mars, 02:41

Qëllohet me armë në drejtim të godinës së Top Channel, vritet roja! Një makinë gjendet e djegur në autostradë, dyshohet e autorëve

27 Mars, 01:56

Luizi me strategji pas daljes së Kiarës: Po bëja sikur po flija! Ja çfarë dëgjoi fshehurazi nga biseda e Oltës dhe Qetësorit

26 Mars, 22:43



Luizi ka çdo gjë gati për planet me Kiarën: Djalit tim do ia vë emrin Amarildo

26 Mars, 22:04

Aplikacioni DigitAlb

Kristi bisedon me Luizin për lidhjen e Lorencit me Keisin: Penalizoi veten dhe atë, do dali të martën! Për mua ishte surprizë

26 Mars, 19:52

'Më dhemb kur Luizi ndihet keq, kam afeksion për të', Olta bisedon me Gertin

26 Mars, 19:23

DW: Simpati në Tiranë për kurajën e Albin Kurtit

26 Mars, 17:55

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje